VENDIM
Nr.297, datë 16.5.2007

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN SI REZULTAT I REHABILITIMIT TË SHKARJEVE TË NDODHURA NË SEGMENTIN RRUGOR ZONA IV, PROSEK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik" dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken si rezultat i rehabilitimit të shkarjeve të ndodhura në segmentin rrugor zona IV, Prosek.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së paraqitur në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 1 546 m^2, tokë/arë, e vlerësuar me 400 lekë/m^2 dhe 630 m^2 tokë/arë, e vlerësuar me 900 lekë/m^2, në shumën e përgjithshme me 1 185 400 (një milion e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e katërqind) lekë.
4. Shpenzimet procedurale, në shumën 179 000 (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 1 185 400 (një milion e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e katërqind) lekësh, të përballohet nga llogaria speciale, e krijuar si transfertë kapitale, për t'u përdorur për shpronësimet.
6. Shpronësimi të fillojë e të përfundojë brenda muajit qershor 2007.
7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve, brenda afatit të parashikuar në pikën 6.
8. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I REHABILITIMIT TË SHKARJEVE TË NDODHURA NË SEGMENTIN RRUGOR ZONA IV, PROSEK

Pronari	Z.K	Nr.Pas	Sip.arë	Çmimi arë lekë/m^2	Vlera tokës (lekë)	Vlerë totale shpronësimi (lekë)
Aleksandër Ndue Ndrejaj	2915	245/2	1546	400 kateg V	618 400	
Zef Ndue Lleshaj	3242	196/4	630	900 kateg III	567 000	1 185 400

Vlera totale e shpronësimit është 1 185 400 (një milion e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e katërqind) lekë.

PLANIMETRIA

SH 1:500



SHENIME:

-POZICIONI I SAKTE PER PUSETES TE KONTROLLIT DO TE PERCAKTOHET NE VEND NGA INXHINIERI NE BASHKEPUNIM ME KONTRAKTORIN DUKE U VENDOSUR NE PIKEN ME TE ULET

-KANALI I DALJES TE TOMBINOS EKZISTUESE DO TE VISHET ME BETON PERTEJ MURIT GJATESOR ME GABIONA

-SHTRESAT E RRUGES NE PJESEN QE KA CEDIME DUHET TEPRISHEN DHE E RINDERTOHEN ,GJATE KETIJ PROCESI TE KONTROLLOHEN ME KUJDES MBUSHJA E TRUPIT TE RRUGES,EDHE NE PJESEN E PA DEMTUAR TE ASFALTIT,NE RAST SE KONSTAQTOHET CILESI E DOBET DUHET TE PRISHET DHE KJO PJESE.

Ing. Granit Nonaj

Infratransproject Ltd. CONSULTING DESIGN SUPERVISION	STUDIM PROJEKTIM MASA INXHINIERIKE KODER KAMEZ, MILOT, PLLANE, RUBIK -ZONA 4 PROSEK-	FAZA PROJEKT-ZBATIM
		SH 1:500
Nr Fletes 09	NENZONA 'C' PLANIMETRIA	TETOR 2004



MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELE-KOMUNIKACIONIT DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE	Drejtori Robert HUTA	Nenshkrimi	Drejtues Projekti Ing. Fisnik KRUJA	Nenshkrimi	Projektues Ing. Fisnik KRUJA Ing. Olset HAXHIU Ing. Blenard DURMISHI	Nenshkrimi	EG - CO	Masa Inxhinierike Ura e Matit dhe Perlat i Eperm (Projekt Zbatimi) MARS | PLANIMETRIA E PROJEKTIT | Fleta No